



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KONTROLI I LARTË I SHTETIT KRYETARI

Adresa: Rruga: Abdi Toptani nr. 1, Tiranë;

E-mail: klsh.org.al; Web-site: www.klsh.org.al

Nr.1040/8 Prot.

Tiranë, më 28.02.2018

V E N D I M

Nr.12, Datë 28.02.2018

PËR

AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË RAJONALE TË ALUIZNI-t KAMËZ-VORË“MBI VLERËSIMIN E AKTIVITETIT EKONOMIKO FINANCIAR, PROCEDURAT E SHQYRTIMIT DHE MIRATIMIT TË KËRKESAVE PËR LEGALIZIMIN E NDËRTIMEVE INFORMALE” për periudhën nga data 01.1.2015 deri më datën 30.09.2017.

Nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë Rajonale të Agjencisë të Legalizimit Urbanizimin dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale Kamëz - Vorë rezultoi që, veprimtaria e subjektit të audituar, në drejtim çështjeve që lidhen me vlerësimin e procedurave të shqyrtimit dhe miratimit të kërkesave për legalizim e objekteve informale, nuk kanë qenë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve të Auditimit dhe Etikës si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

VENDOSA

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për, vlerësimin e aktivitetit ekonomik financiar, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të kërkesave për legalizimin e ndërtimeve informale” të ushtruar në Drejtorinë Rajonale të Agjencisë të Legalizimit Urbanizimin dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale Kamëz-Vorë, sipas programit të auditimit nr. 1040/1, datë 12/10/2017, për veprimtarinë nga data 01.01.2015 deri më datën 30.09.2017

II. Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon;

A. MASA PËR PËRMIRËSIM LIGJOR:

1. Gjetje nga auditimi: Janë konstatuar kontradikta në zbatimin e akteve ligjore lidhur me arkëtimin e taksës së ndikimit të infrastrukturës për objektet informale dhe nga mos arkëtimi i saj, ku si pasojë kemi të ardhura të munguara në dëm të fondit kompensimit pronarëve. Arsyet e dhënies së lejes së legalizimit pa u arkëtuar taksa e ndikimit të infrastrukturës nga DR Aluiznit, Kamëz-Vorë, kanë ardhur nga referimi i pikës 2/1 të VKM nr. 660, datë 21.9.2016 “Për disa ndryshime e shtesa të vendimit 954, datë 25.11.2015, për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe formularit të lejes së legalizimit të ndryshuar” e cila ndër të tjera thotë: “... mungesa e tij nuk pengon miratimin e lejes së legalizimit”. Ndërkohë ky përcaktim (pika 2/1 e VKM nr. 660, datë 21.9.2016 dhe (VKM nr. 860, datë 10.12.2014 pika 5), janë në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 50/2014, datë 15.5.2014 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, neni 27 “Dokumentacioni tekniko-ligjor për legalizimin e objektit informal”, pika ç, ku thuhet: **“Subjekti kërkues i interesuar për legalizimin e objektit pa leje duhet të paraqesë vërtetimin për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për të gjitha rastet, kur subjekti nuk përjashtohet nga pagesa e taksës sipas këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi”**

1.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e Aluiznit Kamëz-Vorë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Aluiznit të përgatisin draft ndryshimin ligjor dhe ti kërkojnë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë përmirësimin ligjor; “Shfuqizimin e pikës 2/1 të VKM nr. 660, datë 21.9.2016 dhe (VKM nr. 860, datë 10.12.2014 pika 5), pasi është në kundërshtim me ligjin nr. 50/2014, neni 27, pika ç, “Për lëshimin dhe pajisjen me vërtetimin, lidhur me pagesën e taksës së ndikimit të infrastrukturës për objektet informale”.

Po kështu, të caktohet me akt nënligjor (në referim të ligjit) kryerja e pagesës dhe subjekti përkatës zbatimi i detyrimit ligjor, pra të ketë një përcaktim të përgjegjësive administrative dhe ligjore për zbatimin e këtij detyrimi ligjor nga punonjësit e administratës. Ky ndryshim është i domosdoshëm, për arsye se ka shkaktuar dëm të konsiderueshëm financiar për financat në NJVQV-të dhe ka lënë shteg për tu përdorur për qëllime dhe përfitime elektorale.

Brenda muajit Mars 2018

2. Gjetje nga auditimi: Është konstatuar se: Ndryshimet ligjore nëpërmjet VKM dhe Udhëzimeve, ku përcaktohet për legalizimin e ndërtimeve dhe shtesave informale pa u shlyer asnjë detyrim, për parcelën ndërtimore dhe për taksën e ndikimit në infrastrukturë, të cilat do të vendosen barra hipotekore, **ka zhveshur forcën dhe funksionimin e ligjit të legalizimit duke lënë të vonuar dhe pa shpresë kompesimin e pronarëve.**

Kështu në këto kushte, **paraqiten dy probleme që kërkojnë përmirësim ligjor, pasi kanë krijuar raport të zhdrejtë midis subjekteve objekt legalizimi dhe pronarëve të tokës, përkatësisht:**

a. lejimi i legalizimit të ndërtimeve informale pa paguar të gjitha detyrimet financiare, në vend që legalizimi të kushtëzohet me shlyerjen e gjitha detyrimeve.

b. Lënia jashtë legalizimit të sipërfaqeve të lira të parcelave ndërtimore, në posedim nga subjektet informale, në vend që të legalizoheshin me pagesë sipas çmimeve të tregut, kujdes duhet treguar për ato raste ku ka plane urbanistike për ndërtim objektesh social-kulturore dhe e lejon konfiguracioni i terrenit.

2.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e Aluiznit Kamëz-Vorë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Aluiznit të përgatisin draft ndryshimin ligjor dhe ti kërkojnë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë përmirësimin ligjor për “Ndryshime” ose “rivlerësim” të pikave të VKM dhe Udhëzimeve që bëjnë fjalë për kohën e pagesës së detyrimeve pas legalizimi, të cilat duhet të kushtëzohen me shlyerjen e gjitha detyrimeve para lejes së legalizimit si dhe legalizimin e sipërfaqeve të lira të parcelave ndërtimore, në posedim nga subjektet informale, me pagesë sipas çmimeve të tregut, përjashtuar ato raste, ku ka plane urbanistike për ndërtim objektesh social-kulturore ku e lejon konfiguracioni i terrenit.

3. Gjetje nga auditimi: U konstatua se liberalizimi i disa kriterëve ligjore për legalizimin e ndërtimeve dhe shtesave informale, nëpërmjet VKM-ve dhe urdhrave nga Drejtori i Përgjithshëm për periudhën 2014-2017, lidhur me ngushtimin distancave të objekteve midis tyre dhe rrugëve dytësore të lagjeve, trotuareve, etj., në zona informale të banuara, pra *lejimi i objektit ngjitur me rrugën e trotuarin ose mbi këtë të fundit, ka krijuar pasoja për të ardhmen, për rastet e fuqive madhore (shirave, përmytjeve, zjarreve etj.)*. Kjo ka sjellë kontradikta me ligjin e planifikimit të territorit, me ligjin e IMTV-ve, pasi mos respektimi i distancave midis banesave, do të krijojë konflikte lidhur me hyrjen në objekt, probleme në zbatimin e planit urbanistik lidhur me zgjerimin e rrugëve brenda lagjeve të diktuar nga nevojat e komunitetit, duke cenuar buxhetin e shtetit për shpronësime të panevojshme.

Përfundimisht, këto kushte ligjore kanë krijuar terren për legalizimin njëherësh të gjitha ndërtimeve dhe shtesave informale, përjashtuar ato në zbatim të nenit 35 të ligjit të legalizimit, duke shmangur kështu riskun e abuzimeve në dhënien e lejeve të legalizimit dhe vonesën e tyre.

3.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e Aluiznit Kamëz-Vorë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Aluiznit të përgatisin draft ndryshimin ligjor dhe ti kërkojnë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë përmirësimin ligjor për “... përmirësim të plotë të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar me ligjin nr. 62/2015 etj, për efekt të përsheptimit të legalizimit të ndërtimeve dhe shtesave informale dhe të zgjidhjes së kontradiktave me ligjin e planifikimit të territorit, ligjin e IMTV, pra për integrimin e tyre pa pasoja sociale dhe ligjore në të ardhmen.

Shënim: Rekomandimet 1.1, 1.2 dhe 1.3 do të përcillen dhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Aluiznit, si rekomandim për përmirësim ligjor.

B. MASA ORGANIZATIVE:

1.Gjetje nga auditimi: Drejtoria Rajonale ALUIZNI Vorë-Kamëz:

-në 18 raste, në Zonën Kadastrale 3993 dhe 2884, komuna Paskuqan, sipas lejeve të legalizimit nr. 70207121, datë 28.03.2017; nr. 70203459, datë 18.06.2016; . 70203460, datë 18.06.2016; nr. 70202958, datë 29.04.2016; nr. 70208147, datë 18.07.2017; 70208561, dt. 14.09. 2017; 70207773, dt. 23.05. 2017; 70208544, dt. 13.09. 2017; 70208419, dt. 23.08. 2017; 70208579, dt. 18.09. 2017; 70208302, dt. 31.07. 2017; 70207949, dt. 31.05. 2017; 70208236, dt. 25.07. 2017; 70208329, dt. 08.01. 2017; 70208452, dt. 31.08. 2017; 70208198, dt. 20.07.17;., nr. 70207945, datë 31.05.2017, nr. 70208339, datë 08.02.2017, *ka kryer legalizime të objekteve informale, në Tokë Arë, pronë “SHTET” dhe privat, në afërsi të Rezervuarit të Paskuqanit, për një sipërfaqe 5603 m² të shitur dhe tjetërsuar në truall privat*, ku nga matjet e kryera në hartën vektoriale, nëpërmjet sistemit AUTOCAD, u konstatua se distanca e objekteve nga bregu i rezervuarit të Paskuqanit është më e vogël se 200 m, distancë që luhetet në segmentin 10 m - 196 m;

-në 11 raste, për sipërfaqen 3842 m², janë kryer legalizime në një zonë ku largësitë e objekteve nga buza e rezervuarit janë më të vogla se 100 ml. Në këto distanca nga rezervuari, *pasuria shtetërore është e patjetërsueshme dhe e paparashkrueshme.*

Sa më sipër nuk duheshin pranuar për legalizim 18 objektet në sipërfaqen e përgjithshme prej 5603 m².

- në 1 rast objekti i legalizuar është ngjitur me kolektorin (godinë banimi 1 kat Kamëz, në ZK 2066, pasuria 82/88), sipas planimetrisë (genplanit) të inspektorëve terrenit, në kundërshtim me ligjin nr. 50/2014 neni 39. Dokumentacioni paraqet kontradikta, pasi në vet deklaram thuhet se kufizohet nga 2 kufitarë privat dhe 2 anët tjera me kanal dhe kolektor, ndërsa në planimetrinë përmenden 3 kufitarë privat dhe në jug thuhet rrugë.

-në 3 raste, në Zonën Kadastrale 1066, etj., sipas lejeve të legalizimit nr. 70201164, datë 29.01.2016; 665268 datë 09.05.2015; 665265 datë 09.06.2015, ka kryer legalizimin e ndërtimeve informale në kushtet kur këto objekte ndodhen **1-5.3 m** larg nga kanalet kullues kryesore dhe dytësore, pra është ngritur brenda brezit mbrojtës të sistemeve kryesore të kullimit,

të mbrojtura sipas ligjit nr. 8518, datë 30.7.1999, "Për ujtitjen dhe kullimin", të ndryshuar, si dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, ku distance minimale e lejuar është 4 m – 8m.

Sa më sipër bie në kundërshtim me germën "ç", neni 56, të ligjit nr. 9860, datë 21.01.2008, për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8518, datë 30.07.1999 "Për Ujitjen dhe Kullimin", VKM nr. 280, datë 01.04.2015 "Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje", i ndryshuar, Kreu III, pika 4, germa "e" dhe ligjin nr. 111/2012, datë 15.11.2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", neni 1, pika 2, germa "a"; neni 4, pika 8; neni 5 dhe neni 84.

1.1. Rekomandim: Drejtoria Rajonale ALUIZNI Vorë-Kamëz në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë, t'i kërkojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, që për objektet informale të pajisura me leje legalizimi sa më sipër, të fillojë procedurat për shfuqizimin e lejeve të legalizimit të dhëna në kundërshtim, me dispozitat e ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin, integrimin e zonave informale", i ndryshuar, dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

Menjëherë

2.Gjetje nga auditimi: Drejtoria Rajonale ALUIZNI Vorë-Kamëz në 13 raste të Zonës Kadastrale 3993 dhe 2884, Komuna Paskuqan, sipas lejeve të legalizimit 70201436, dt.27.11.2015; 70201291, dt.19.11.2015; 70201288, dt.04.12.2015; 7020993, dt.30.10.2015; 702010, dt.15.19.2015; 7020564,dt. 05.09.2016; 70202017,dt.02.12.2016; 70204818, dt.15.09.2016; 70204305, dt. 04.08.2016; 70208582, dt.19.09.2017; 70206692, dt.31.01.2017, 70206237, dt.17.12.2016, 70208582, dt.19.09.2017; ka kryer legalizime të objekteve informale, në Tokë Arë, pronë "SHTET" dhe privat, në afërsi të Lumit të Tiranës, **për një sipërfaqe 4483 m² të shitur dhe tjetërsuar në truall privat**, ku nga matjet e kryera në hartën vektoriale, nëpërmjet sistemit AUTOCAD, u konstatua se distanca e objekteve nga bregu i të Lumit të Tiranës, është më e vogël se 100 m, distancë që luhet në segmentin 44 m -121 m, distancë brenda së cilës, *pasuria shtetërore është e patjetërsueshme dhe e paparashkrueshme.*

Sa më sipër, nuk duheshin pranuar për legalizim **13 objektet në sipërfaqen e përgjithshme prej 4483 m².**

Veprimet e kryera bien në kundërshtim me ligjin nr. 111/2012, datë 15.11.2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", neni 1, pika 2, germa "a"; neni 4, pika 8; neni 5 dhe neni 84, si dhe me VKM nr. 280, datë 01.04.2015 "Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtimet me leje", Kreu III, pika 4, germa "dh" dhe Kreu II, pika 2, germa "gj".

2.1. Rekomandim: Drejtoria Rajonale ALUIZNI Vorë-Kamëz në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë, t'i kërkojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, që për objektet informale të pajisura me leje legalizimi sa më sipër, të fillojë procedurat për shfuqizimin e lejeve të legalizimit të dhëna në kundërshtim, me dispozitat e ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin, integrimin e zonave informale", i ndryshuar, dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

Menjëherë

3.Gjetje nga auditimi: Drejtoria Rajonale ALUIZNI Vorë-Kamëz:

-në 13 raste, në Zonat Kadastrale 3974,3993,1066,2726,etj.,sipas lejeve të legalizimit nr. 70204792, datë 01.09.2016 ; nr. 70204836, datë 19.09.2016; nr. 70207166, datë 29.03.2017; nr. 70202116, datë 16.02.2016; 70207279, datë 31.03.2017; nr. 70201164, datë 29.01.2016; nr. 70203346, datë 30.05.2016; nr. 70208458, datë 31.08.2017; nr. 70208665, datë 05.09.2017, nr. 665189 datë 28.04.2015; nr. 665207 datë 29.04.2015; nr. 665254 datë 30.04.2015; 666458 datë 01.08.2015, ka kryer legalizime të ndërtimeve informale të cilat kufizohen me rrugë automobilistike të kategorive B dhe C, **në distancë prej rrugëve deri në 10 m**, kur distancat e lejuara nga rrugët interurbane të këtyre kategorive janë:

20 m për rrugët e kategorisë B

10 m për rrugët e kategorisë C.

-Në 4 raste u konstatua mosrespektim të distancës të ndërtimit informal nga rruga kombëtare , në 1 rast objekti i legalizuar ndodhet në kushtet mos respektimit të distancës mbi 100 metra nga

bregu i rezervuarit (liqenit) Paskuqan, ku sipas dokumentacionit në dosje, si genplani, harta dixhitale e paraqitur, rezulton se objektet ndodhen në një distancë prej cepit të rrugës nacionale me pak se përcaktimet ligjore, në kundërshtim me nenin 39 të Ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” të ndryshuar, me kap II/a të VKM nr. 280, datë 1.4.2015, me Ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998 i ndryshuar “Kodi rrugor në Republikën e Shqipërisë”, neni 2 “Përcaktime dhe klasifikime rrugësh” dhe neni 4, “Përcaktimi i qendrave të banuara”, me VKM nr. 153, datë 07.04.2000 “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor në Republikën e Shqipërisë” neni 25, pika 2 si dhe me VKM nr. 756 datë...10.2016 pika 2 /a/i, kapitulli II ku thuhet:....**ii. 20 metra për rrugët e kategorisë B....**, konkretisht:

* *godinë banimi 2 kat Vorë*, për parcelën ndërtimore me sipërfaqe 234 m² në ZK 2605, pasuria 40/59, rezulton se sipas ortofotos digjitale, planimetrisë (*skicës fushore genplanit*) të akt konstatimit në terren datë 26.08.2014 pasqyrohet 7,4 metër nga rruga Tr-D, nga mbi 20 metër që duhej. Objekti është kualifikuar dhe është në pritje (proces) për pajisjen me leje legalizimi.

* *ndërtimi informal 5 kat bashkëngjitur* me shtesën 2 kat i legalizuar me lejen 70207397, datë 10.04.2017, në ZK 2066, pasuria 347/14/2, ku paraqet ngushtim të trotuarit pranë rrugës nacionale Bulevardi Blu (B), pasi shkallët hyrëse të katit II dhe tenda e marketit të katit përdhe të objektit shtrihen dhe prekin pjesërisht trotuarin e këmbësorëve.

*, *godinë banimi 2 kat +1 kat nën tokë Vorë*, me leje legalizimi 70206999 datë 17.03.2017, për parcelën ndërtimore me sipërfaqe 416,5 m², në ZK 3127, pasuria 40/87, objekti ndodhet në distancën 13,3 metra larg rrugës nacionale, sipas planimetrisë (*skicës fushore genplanit*) të akt konstatimit në terren datë 10.01.2014.

* *godinë shërbimi 1 kat, Kamëz*, për parcelën ndërtimore shtet me sipërfaqe 94,3 m² (*sipërfaqe ndërtimi 34,4 m² dhe sipërfaqe totale ndërtimi 34,4 m²*, në ZK 3992, pasuria 11/81, nuk është respektuar distanca e ndërtimit informal (dyqan fruta perime) me rrugën nacionale bulevardi blu, pasi është 0,5 metër, sipas hartës vektoriale dhe jo 2.4 metër sipas akt verifikimit në terren datë 30.01.2017. Theksojmë se relacioni i hartografisë, sektorit pronësisë dhe sektorit Legalizimit nuk e justifikon legalizimin e objektit, pasi është zvogëluar me 6,19 m² parcela ndërtimore dhe jo objekti, pasi problem paraqet objekti i cili është afër me rrugën nacionale. Mungon pamja vizuale e objektit nga 3 anët e rrugës, si dhe mungojnë 3 fotot e objektit në terren, por është mjaftuar vetëm me fotografimin e objektit nga prapa.

* *godinë e kombinuar 4 kat, Vorë*, me leje legalizimi nr. 70206809, datë 15.02.2017, në ZK 2726, pasuria 40/53, rezulton se: nuk është respektuar distanca 20 metër e ndërtimit informal (*godinë 4 kat e kombinuar*) me rrugën nacionale Autostrada, pasi është 6,5 metër dhe 14 metër në cepin tjetër të objektit, sipas planimetrisë (*skicës fushore*) në terren date 26.10.2016, ndërsa nga matjet tek harta vektor sipas fotografimit satelitor distanca rezulton 1,8 metër nga rruga.

* *godinë banimi 2 kat Paskuqan*, me leje legalizimi 70208501, datë 07.09.2017, për parcelën ndërtimore me sipërfaqe 500 m² në ZK 2884, pasuria 697/4, veprim në kundërshtim me nenin 1 pika 2/a, neni 4 pika 8, neni 5 dhe neni 84 të ligjit nr. 111/2012 datë 15.12.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, me VKM nr. 280, datë 01.04.2015 kap II/gj.

Sa më sipër bie në kundërshtim me VKM nr. 280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, i ndryshuar, Kreu III, pika 4, germet “a” dhe “b”, ku distancat nga kufiri rrugor për rrugët e kategorisë “C” brenda qendrave të banuara është 10 m .

3.1. Rekomandim: Drejtoria Rajonale ALUIZNI Vorë-Kamëz në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë, t’i kërkojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, që për objektet informale të pajisura me leje legalizimi sa më sipër, të fillojë procedurat për shfuqizimin e lejeve të legalizimit të dhëna në kundërshtim, me dispozitat e ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin, integrimin e zonave informale”, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Drejtoria Rajonale ALUIZNI Vorë-Kamëz, në 6 raste objektet e ndërtuara nuk kanë respektuar distancat nga rruga e trotuari dhe nga këto 2 janë pranë kolektorëve, në kundërshtim me ligjin mbi urbanistikën dhe me nenin 39, të ligjit nr. 9482, datë

03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar, si dhe në kundërshtim me *kreut II pika II (a) dhe Kreu III të VKM, nr. 280, datë 01.04.2015* " Kriteret për legalizimin e ndërtimeve në zonat informale të miratuara.

-në 1 rast objekti informal godinë e kombinuar 5 kat Kamëz, në ZK 2066, pasuria 347/14/2, paraqet bashkëngjitur **shtesën 2 kat të legalizuar, e cila ka ngushtuar trotuarin pranë rrugës nacionale Bulevardi Blu (B), pasi shkallët hyrëse të katit II dhe tenda e marketit të katit përdhe të objektit shtrihen dhe prekin pjesërisht trotuarin e këmbësorëve**, në kundërshtim me nenin 31/1/a dhe 39 të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” të ndryshuar, me pikën 4/a/b të VKM nr. 438, datë 28.6.2006 si dhe me ligjin nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, me VKM nr. 502, datë 13.07.2011 “Për miratimin e rregullores të kontrollit të zhvillimit të territorit” e ndryshuar me VKM nr. 88, datë 07.02.2012, VKM nr. 139, datë 22.02.2012, VKM nr. 345, datë 09.05.2012 dhe VKM nr. 314, datë 13.3.2013.

4.1. Rekomandim: Drejtoria Rajonale ALUIZNI Vorë-Kamëz në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë, t’i kërkojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, që për objektet informale të pajisura me leje legalizimi sa më sipër, të fillojë procedurat për shfuqizimin e lejeve të legalizimit të dhëna në kundërshtim, me dispozitat e ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin, integrimin e zonave informale”, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

Menjëherë

5.Gjetje nga auditimi: Drejtoria Rajonale ALUIZNI Vorë-Kamëz **në 15 raste**, sipas lejeve të legalizimit 70205492, datë 02.11.2016; nr. 70204318, datë 08.08.2016; nr. 70207121, datë 28.03.2017; 70208092, datë 19.06.2017; 70208544, datë 13.09.2017; 70208419, datë 23.08.2017; 7020, datë 08.02.2017; 70208579, datë 18.09.2017; 702010, datë 15.09.2015; 70208582, datë 19.09.2017; 70208722, datë 25.09.2017; 70207945, datë 31.05.2017, 70208329, datë 08.01.2017; 70208236, datë 25.07.2017; nr. 70208339, datë 08.02.2017; ka kryer legalizimin e objekteve informal në mungesë pa nënshkrim të deklaratës personale, për marrjen përsipër të përgjegjësisë për çdo pasojë, që mund të rrjedhë nga shkaqe natyrore dhe /ose nga përdorimi i banesës, ku shteti nuk është përgjegjës për kompensimin ose dëmshpërblimin në raste fatkeqësish, për shkak të faktorëve që ndikojnë në qëndrueshmërinë e objektit, *mosveprim në kundërshtim me nenin 27, germa “dh” e ligjit nr. 9482, datë 04.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje, të ndryshuar.*

5.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale ALUIZNI Vorë-Kamëz të marrë masa për të ardhmen, duke mos lëshuar leje legalizimi për objektet dhe ndërtimet informale, në kushtet e mungesës në dokumentacionin e paraqitur për aplikim, të deklaratës personale, për marrjen përsipër të përgjegjësisë për çdo pasojë, që mund të rrjedhë nga shkaqe natyrore dhe/ose nga përdorimi i banesës, ku shteti nuk është përgjegjës për kompensimin ose dëmshpërblimin në raste fatkeqësish, për shkak të faktorëve që ndikojnë në qëndrueshmërinë e objektit.

Në vijimësi

6.Gjetje nga auditimi: Drejtoria Rajonale ALUIZNI Vorë-Kamëz:

-në të gjitha rastet e audituara ka kryer legalizimin e objekteve informale, në kushtet e plotësimit me mangësi të proces-verbaleve të verifikimit në terren, ku përsa i përket pasurive kufitare (të saktësuara në përshkrim), proces-verbali i verifikimit në terren nuk është plotësuar me emrin mbiemrin e pronarit që e disponon ose rrugë/kanal, etj. Kështu, *nuk janë shënuar emrat e rrugëve, kategoritë e këtyre rrugëve si dhe nuk janë shënuar distancat nga pasuritë kufitare, veprime në kundërshtim me urdhrat nr. 766, datë 10.09.2014 dhe nr. 851, datë 27.05.2015 të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t, të cilët kanë përcaktuar formularin e proces-verbalit.*

-në 4 raste nuk përcaktohet hyrja në parcelën ndërtimore ose në objekt, sipas genplanit, në kundërshtim me pikën 1.3, Urdhër nr. 291, datë 01.09.2008, “Për miratimin e manualit “Hartimi dhe paraqitja e materialeve grafike (genplan, ortofoto, planimetri), të objektit që legalizohet“, me pikën 2.7/c/iii të urdhrat nr. 8 datë 30.10.2006 “Për miratimin manualit të hartimit dhe paraqitjes së materialeve grafike”, konkretisht:

- pasuria shtet 9/893, në ZK 3992, banesë 2 kat me leje legalizimi nr. 70207607, datë 30.04.2017,

- pasuria 2/296, në ZK 3992, banesë 1 kat me leje legalizimi nr. 70207266, datë 31.3.2017,
- pasuria 40/55/2, në ZK 2183, godinë e kombinuar 3 kat Vorë me leje legalizimi nr. 70207076,
- pasuria 38/10, ZK 1649, objektit informal 3 kat banimi, Kamëz (Valias).

Këto mangësi, veçanërisht mungesa e distancave nga objektet kufitare e kthejnë proces-verbalin e verifikimit në terren në një dokument formal, kur ky është dokumenti bazë për verifikimin e situatës në terren, pavarësisht hartave vektoriale dhe pamjeve të tjera dixhitale. Largësitë nga objektet kufitare janë elementi bazë për legalizimin e objekteve, si nga rrugët, hekurudha, lumenjve, rezervuarëve, etj., pra janë bazë për pezullimin e lëshimit të lejeve të legalizimit, nëse distancat nuk zbatohen sipas VKM nr. 280, datë 01.04.2015.

6.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale ALUIZNI Vorë-Kamëz të marrë masa për të ardhmen, duke mos lëshuar leje legalizimi për objekte dhe ndërtime informale, në kushte të mosplotësisimit sipas legjislacionit në fuqi dhe urdhrave të brendshëm të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t, të proces-verbaleve të verifikimit në terren: me distancat e objektit nga pasuritë kufitare me shifra dhe fjalë, me emrin mbiemrin e pronarit që e disponon, rrugë/kanal, etj., emërtimet e kufitarëve, me emrat e rrugëve, kategoritë e rrugëve urbane, interurbane, etj.

Në vijimësi

7.Gjetje nga auditimi: *Drejtoria Rajonale ALUIZNI Vorë-Kamëz* në të gjitha rastet e audituara nuk ka plotësuar dokumentacionin e praktikave të këtyre lejeve me numër inventari progresiv fletësh, ndërsa fletët e inventarit të dosjeve janë të panënshkruara nga dorëzuesi (specialisti) i cili ka përpunuar dosjen.

-**Në 26 raste**, sipas lejeve të legalizimit nr. 70203346, datë 30.05.2016; nr. 70202116, datë 16.02.2016; nr. 70207166, datë 29.03.2017; nr. 70201288, datë 04.12.2015; nr. 70204818, datë 15.09.2016; nr. 70202017, datë 02.12.2016; nr. 70208452, datë 31.08.2017; nr. 70207949, datë 31.05.2017; nr. 70208561, datë 14.09.2017; nr. 70202958, datë 29.04.2016; nr. 70205014, datë 11.10.2016; nr. 70207121, datë 28.03.2017; nr. 70208579, datë 18.09.2017; 70208339, datë 08.02.2017; nr.70208419, datë 23.08.2017; 70208544, datë 13.09.2017; 70207773, datë 23.05.2017; 70208092, datë 19.06.2017; 70204299, datë 03.08.2016; 7020305, datë 04.08.2016; 70208582, datë 19.09.2017; 70208722, datë 20.09.2017; 70207945, datë 31.05.2017; 70208198, datë 20.07.2017; 70208329, datë 08.01.2017; 70208236, datë 25.07.2017, mungojnë inventaret e dosjeve. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme vijnë në kundërshtim me Ligjin Nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për Arkivat”.

7.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale ALUIZNI Vorë-Kamëz të marrë masa për të kryer, kryer inventarizim të plotë të arkivës së institucionit,veçanërisht të inventarizojë dosjet e cituara më sipër të pa inventarizuar, plotësimin e çdo praktike me inventarin me numër progresiv fletësh, ku fletët e inventarit të dosjeve të jenë të nënshkruara nga dorëzuesi (specialisti) i cili ka përpunuar dosjen dhe arkivisti (marrësi në dorëzim), sipas ligjit për Arkivat.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Kamëz - Vorë në marrjen e vendimeve “Për kualifikimin për legalizim të objektit informal”, ka vepruar pa kërkuar e administruar në dosje vërtetimin e taksës së infrastrukturës në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 me ndryshime, nenin 27 “Dokumentacioni tekniko-ligjor për legalizimin e objektit”, gërma “ç”- *vërtetimin për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë*, mbi pagesën e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë nga pushteti vendor, duke krijuar **në vlerën 175,886 mijë lekë mungesë të ardhurash ne buxhetin e shtetit** .

8.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Kamëz -Vorë për nevoja të plotësisimit të dokumentacionit tekniko-ligjor të objekteve me lejeve të legalizimit të lëshuara, t’i kërkojë Njësitë të Vetëqeverisjes Vendore të Bashkisë Kamëz dhe Vorë, vërtetimet mbi likuidimin e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë në **vlerën prej 175,886 mijë lekë. Të dërgojë zyrtarisht listën dhe vlerat përkatëse në ZVRPP Tiranë, e cila ka për detyrë të vendosë shënimin përkatës në kartelat e regjistrimit të lejeve të legalizimit**

Menjëherë dhe në vijimësi

9.Gjetje nga auditimi: Drejtoria e ALUIZNI-t Kamëz - Vorë nuk ka të administruar (gjurmë auditimi) dokumentacionin shkresor për s'kualifikimin e **1200 objekteve të ndërtuara në zonën historike, arkeologjike apo zonë e mbrojtur**, si dhe nuk disponon dokumentacion për informimin e Drejtorisë së Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë dhe institucionet e vetëqeverisjes vendore në Bashkinë Vorë dhe Kamëz. Veprime në kundërshtim me neni 38 "Dhënia e lejes së legalizimit" dhe nenin dhe 39, të ligjit nr. 9482 datë 03.04.2006 me ndryshime.

9.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Kamëz - Vorë të marrë masa dhe të dokumentojë në një regjistër të veçantë objektet informale të ndërtuara në kundërshtim me legjislacionin në fuqi (zona të mbrojtura, arkeologjike, etj.), duke informuar në çdo rast Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë dhe Bashkinë Kamëz dhe Vorë, për marrjen e masave për këto objekteve të përjashtuara nga procesi i legalizimit.

Brenda muajit Mars 2018

10. Gjetje nga auditimi: Në Drejtorisë e ALUIZNI-t Kamëz janë arkëtuar gjithsej 33,849,518 lekë nga legalizimi i objekteve informale me sipërfaqe 16479.5 m², nga këto të ardhura, deri në kohën e auditimit, kanë mbaruar procedurat për kompensim pronarësh për sipërfaqen prej 10,280 m² me vlerë 18,321,171 lekë, ndërsa për vlerën **15,528,347 lekë**, nuk janë kryer procedura për kompensim sipas kërkesave të Udhëzimit nr. 1451, datë 22.09.2016, pika 9, si dhe Neni 34 "Njohja e sipërfaqes së parcelës ndërtimore për efekt kompensimi", Pika 1 dhe ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", i ndryshuar.

10.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Kamëz - Vorë të marrë masa që në vijimin e kryerjes së procesit të legalizimit të objekteve informale, për të gjitha objektet e ndërtuara në pronat e ish pronarëve, të përgatisë në afatet e caktuara kohore dosjet e pronarëve të cilat nuk janë kompensuar në vlerë **15,528,347 lekë** për sipërfaqen 6217 m².

Menjëherë e në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Në Drejtorisë e ALUIZNI-t Kamëz, për **2594 objekte** kanë zbatuar VKM nr.954, datë 25.11.2015 dhe VKM 1095, datë 28.12.2015, për dhënien e lejes së legalizimit vetëm për objektin, **pa u likuiduar parcelat ndërtimore**. Pra konstatohet se nuk kanë përfunduar procesin e legalizimit, nuk kanë dalë VKM-të për të likuiduar detyrimin e parcelave ndërtimore, duke zgjatur procesin e legalizimit dhe afatet kohore në kundërshtim me Urdhrin nr. 37 datë 19.01.2016 për "Matricën e procedurave dhe afateve kohore për shqyrtimin administrativ për legalizim", Pika 6 dhe 7, mos përputhje me neni 17 (pika 5) dhe nenit 27 të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 me ndryshime, si dhe pika 8 e VKM 280 date 01.04.2015, duke krijuar vonesa në likuidimin e tarifave të parcelave ndërtimore, për vlerën **1,556,400,000 (lekë + bono privatizimi)**, si e ardhur e munguar në buxhetin e shtetit.

11.1. Rekomandim: Drejtoria Rajonale ALUIZNI Vorë-Kamëz të marrë masa, të ndjekë procesin në Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë mbi mos daljen e VKM për legalizim, ku si pasojë kemi mos arkëtimin e të ardhurave nga viti 2016 në vlerën **1,556,400,000 lekë** dhe zgjatje të panevojshme të procedurave të legalizimit.

Në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Në 1 rast objektet e ndërtuara dhe legalizuar në shkelje me nenin 17, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 me ndryshime, **leja e legalizimit me nr. 662979 datë 19.01.2015** proceduesi K.G.P me objekt ndërtimi 142 m² dhe parcele ndërtimore 558.1 m² proceduesit i janë dhënë më tepër **132.1 m² toke shtet e cila** nuk përshtatet me konfiguracionin e parcelës dhe pa deklarate noteriale .

12.1. Rekomandim: Drejtoria Rajonale ALUIZNI Vorë-Kamëz të rivlerësojë lejen e legalizimit me nr. 662979 datë 19.01.2015 proceduesi K.G.P për 131.1 m² të mare me tepër dhe të ndjekë procedurat sipas ligjit .

Brenda muajit Mars 2018

13. Gjetje nga auditimi: Në 2 raste shkelje procedurash të legalizimit, **leja e legalizimit me nr. 667059 datë 26.08.2015 proceduesi M.N.S**, në vet deklarimin datë 09.11.2006 përshkruhet se objekti që do të legalizohet ka dhe një objekt tjetër në fotot e paraqitura duket një objekt një kate, por në dosje nuk ndodhet as një dokument, prishje ose njoftim për objektin e pa legalizuar por

nga specialistet e tereni shkruhet se objekti do te priset ndodhet pranë rrugës dhe nga inspektorët e terrenit ne proces verbalin datë 11.08.2015. Në gentplanin e administruar, objekti nuk pasqyrohet sipas hartës dixhitale objekti është ekzistues, leja e legalizimit me nr. 666398 datë 27.07.2015 proceduesi XH.H.H, janë legalizuar 2 kate në fotot e paraqitura, por fakti është se pallati është 3 kate. Këto veprime në kundërshtim me ligjin 9482, datë. 03.04.2006 .

13.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale ALUIZNI Vorë-Kamëz të marrë masa që të kërkojë nga subjekti plotësimin me dokumentet e nevojshme, si dhe për të ardhmen të ndjekë procedurat ligjore dhe të qartësojë çdo veprim të sektorëve përkatës për veprimet e kryera në përputhshmëri me ligjin për legalizimin e objekteve informale.

Menjëherë dhe në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Në Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t Kamëz nuk ka regjistër me te gjitha te dhënat e objekteve te legalizuara, lejet e shpërndara proceduesve, lejet gjendje lejet e dërguara në ZVRPP rezultuan se janë pa u pajisur me leje legalizimi 830 objekte të “Kualifikuara”. Sipas të dhënave të raportuara në DPA-Tiranë, se dërguar në ZRPP 8079 objekte informale, në fakt janë 6692 objekte informale, pra me një diference 1387 objekte të raportuara me shumë Drejtorisë Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë, në kundërshtim me nenin 15, pika 4 e Rregullores me nr. 117, datë 14.07.2015.

14.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale ALUIZNI-t Vorë-Kamëz të marrë masa për evidentimin e plotë, rakordimin me Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë dhe të ndiqen procedurat për lejet e legalizimit sipas afateve ligjore.

Brenda muajit Mars 2018 e në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Drejtoria Rajonale ALUIZNI Kamëz-Vorë për periudhën e 6-mujorit të parë 2017 ka dhënë me vonesë 1,635 leje e legalizimi për ndërtime dhe shtesa informate (për 548,075 m2 sipërfaqe parcele ndërtimore, për 330,529 m2 sipërfaqe totale ndërtimore për banim dhe 27,451 m2 sipërfaqe ndërtimore për aktivitet social-ekonomike si dhe 187,817 m2 sipërfaqe bazë ndërtimi), pasi vet deklarimet janë bërë në vitin 2006, konstatimi, kualifikimi dhe VKM janë bërë mbi 1 vit më parë, çka ka nxjerrë jo me efektivitet punën e ALUIZNI-t, në përmbushjen e misionit të legalizimit të zonave informate, në kundërshtim me nenin 28 të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje“ i ndryshuar.

-Nuk është respektuar në disa raste afati prej 60 ditësh nga data e mbajtjes së procesverbalit të konstatimit në terren deri në marrjen e vendimit për kualifikimin ose jo të objektit, në kundërshtim me VKM nr. 280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtime pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, pika.

15.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale ALUIZNI Kamëz-Vorë të marrë masa për zbatimin e procesit të legalizimeve për ndërtime dhe shtesat informale të prapambetura brenda afateve të caktuara ligjore.

Në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Drejtoria Rajonale ALUIZNI Kamëz-Vorë nuk ka mbajtur evidenca mbi sipërfaqet e lira në pronësi shtet, lënë jashtë procesit të legalizimit dhe të pamundura për parcelizim për vetë pozicionin gjeografik që kanë, **por që posedohen nga subjektet pa asnjë detyrim financiar apo qiraje, pra** nuk ka marrë asnjë masë për të njoftuar dhe bashkëpunuar me institucionet vendore, për vënien në dispozicion të listës së sipërfaqeve të lira, konfirmimin e tyre në pronësi shtet, apo dokumentimin e tyre si hapësira që përdoren nga qytetarët pa u taksuar.

-Mungon deklarata noteriale nga individët të cilat pranojnë ose refuzojnë të blejnë truallin sipas çmimit të tregut për pjesën e parcelës të zaptuar e cila është mbi normën ligjore, mbi 3- fish dhe nën 500 m2.

-Këto parcela janë zvogëluar me qëllim për të qenë në kufirin deri në 300/500 m², sipas genplaneve, hartës fushore, ortofotos digjitale dhe hartës vektoriale të pronësive, ku sipërfaqet e pa legalizuara duhet t'i ishin bashkëngjitur sipërfaqes së legalizuar për vetë pozicionin gjeografik që ndodhen, në kundërshtim me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 30, datë 15.01.16 “Për mënyrën e hartimit dhe paraqitjes së dokumentacionit teknik (*gen-plan, planimetri*)”, i ndryshuar,

si dhe shkronja “f” dhe “g” e nenit 3 dhe pika 1 e nenit 17, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar.

16.1. Rekomandimi: Drejtoria ALUIZNI Kamëz-Vorë të marrë masa të menjëhershme për të administruar dhe mbajtur evidencë të saktë dhe në mënyrë të vazhdueshme, mbi sipërfaqet e lira në pronësi shtet lënë jashtë procesit të legalizimit dhe të pamundura për parcelizim për vetë pozicionin gjeografik që kanë, të njoftojë me shkresë institucionet vendore dhe ato kompetente si Bashkinë Kamëz dhe Vorë. Të vendosë në dispozicion të këtyre NJVQV-ve listën me sipërfaqe të lira, konfirmimin e tyre në pronësi shtet dhe dërgimin NJVQV-ve për ti vlerësuar e përdorur si ambiente publike, etj.

-Të argumentohet dhe të merret deklarata noteriale nga individët lidhur me legalizimin e sipërfaqes së parcelës ndërtimore, mbi masën e trefshit të bazës së ndërtimit, pavarësisht se nuk është më e madhe se 500 m²,

Menjëherë e në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Në 3 raste u konstatua ndryshim të numrit të ZK dhe në 1 rast ndryshim të numrit të pasurisë, konkretisht:

-pasuria 40/55/2 në zonën kadastrale 2183 paraqitet ndryshe në dokumentet e hipotekës, pasi ajo përcaktohet në ZK 3127. Theksojmë se kjo pasuri kufizohet me pasurinë 40/53, e cila shtrihet në ZK 2726. Po kështu është ndryshuar pasuria nga 54/97 në pasurinë 54/197.

- Pasuria 38/10/1 paraqitet në ZK 2066 (*sipas genplanit*), ndërsa në Lejen e legalizimit nr. 666456, datë 7.8.2015, në akt kualifikimin datë 14.07.2015 dhe në certifikatën e pronësisë datë 12.10.2005 kjo pasuri 38/10 (*me sipërfaqe totale 401,4 m²*) pasqyrohet në ZK 1649 .

17.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale ALUIZNI Kamëz-Vorë të saktësojë 3 rastet e ndryshimit të numrit të ZK 2066 dhe në 1 rast ndryshimit të numrit të pasurisë (40/55/2, 54/197, 38/10/1).

Deri më 30.03.2018

18. Gjetje nga auditimi: Në 7 raste mungon statusi juridik i pasurisë, në kundërshtim me nenin 27/d të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” ndryshuar me ligjin 50/2014, dhe nr. 62/2015, përkatësisht:

* godinë banimi 1 kat, Paskuqan, Kamëz, , për parcelën ndërtimore 103,2 m² në ZK 1066, pasuria 230/375. me leje legalizimi nr. 70206564, datë 27.01.2017,

* godinë banimi 2 kat +1 kat nën tokë Vorë, për parcelën ndërtimore 373,5 m² , në ZK 2183, pasuria 182/30/10, me leje legalizimi nr. 70206819, datë 17.02.2017,

* godinë banimi 1 kat Kamëz, për parcelën ndërtimore 274,5 m² , në ZK 2066, pasuria 82/88, me leje legalizimi nr. 70206750, datë 13.02.2017,

* godinë banimi 1 kat Kamëz, për parcelën ndërtimore me sipërfaqe 260 m² në ZK 2066, pasuria 12/26, me leje legalizimi nr. 70206814, datë 16.02.2017,

* godinë banimi 1 kat+papafino, Vorë, për parcelën ndërtimore 343,5 m², në ZK 2596, pasuria 135/97/1, me leje legalizimi nr. 70208051, datë 15.06.2017,

* godinë shërbimi 1 kat, Paskuqan, për parcelën ndërtimore 350,7 m² në ZK 3993, pasuria 1225/4, me leje legalizimi nr. 70207390, datë 11.04.2017,

* godinë shërbimi 2 kat Kamëz, për parcelën ndërtimore me sipërfaqe 75,3 m² në ZK 2066, pasuria 52/144/2, me leje legalizimi 70206935, datë 27.02.2017.

18.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale ALUIZNI Kamëz-Vorë të sigurojë në dosjet e subjekteve statusin juridik të 7 pasurive të legalizuara, të lartpërmendura.

Brenda muajit Mars 2018

19. Gjetje nga auditimi: Në 2 raste nuk është legalizuar ngrehina funksionale (mur rrethues ose ngrehinë ndihmëse) brenda sipërfaqes parcelës ndërtimore, konkretisht:

* godinë e kombinuar 5 kat Kamëz, me leje legalizimi 70207397, datë 10.04.2017, për parcelën ndërtimore me sipërfaqe 500 m², në ZK 2066, pasuria 347/14/2, nuk është legalizuar ngrehina funksionale 1 kat me 40 m² dhe 60 ml mur rrethues brenda sipërfaqes parcelës ndërtimore, sipas procesverbalit të terrenit datë 01.03.2007 dhe vet deklarimit të subjektit date 15.08.2006. Ndryshe

është vepruar tek legalizimi i godinës të banimit të 3 kat ZK 2066, pasuria 123/11 ku është legalizuar edhe objekti ndihmës.

* banesë 1 kat, me leje legalizimi nr. 70207266, datë 31.3.2017, për parcelën ndërtimore me sipërfaqe 180 m² në ZK 3992, pasuria 2/296, nuk është legalizuar ngrehina funksionale ose muri rrethues 40 ml pasqyruar në vet deklarin datë 17.11.2006 brenda sipërfaqes parcelës ndërtimore,

Veprime në kundërshtim me pikën 2 të nenit 2 ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje“, ndryshuar me ligjin nr.50/2014 neni 2, pika 3.

19.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale ALUIZNI Kamëz-Vorë në të ardhmen të mbajë parasysh legalizimin e ngrehina funksionale brenda sipërfaqes parcelës ndërtimore.

Brenda muajit Prill 2018 e vijimësi

20. Gjetje nga auditimi: Në 1 rast objekti informal, ndodhet 1,9 metër afër objektit të kultit Xhamia, sipas gen planit dhe planimetrisë të inspektorëve të terrenit datë 02.12.2016, (godinë banimi 2 kat, Valias i ri, Kamëz, për parcelën ndërtimore 420,9 m² në ZK 2066, pasuria 43/108/1).

20.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale ALUIZNI Kamëz-Vorë të marrë masa që në të ardhmen të respektojë distancat e duhura sipas ligjit nga objektet e kultit.

Në vijimësi

21. Gjetje nga auditimi: Në 1 rast objekti informal 1- kat paraqitet karabina pa mbulesë me çati ose soletë (godinë banimi 1 kat Kamëz me leje legalizimi nr. 70206750, datë 13.02.2017, për parcelën ndërtimore me sipërfaqe 274,5 m², në ZK 2066, pasuria 82/88), sipas fotove të vet deklariesit, në kundërshtim me ligjin nr. 50/2014 ndryshuar me nr.62/2015 neni 3, shkronja “a” .

21.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale ALUIZNI Kamëz-Vorë të sigurojë në dosje dokumente për objektin e legalizuar nëse ai është me mbulesë çatie ose soletë si dhe të mbikëqyrë respektimin e kateve e shtesave që mund të bëhen në të ardhmen.

Deri më 30.10.2018

22. Gjetje nga auditimi: Në 1 rast objekti i legalizuar 1 kat + bodrum, rezulton ndryshe sipas fotove të objektit, pasi është 2 kat mbi tokë, konkretisht godinë shërbimi e kombinuar 1 kat+podrum mbi tokë, në ZK 2066, pasuria 27/31/1. Fakt tjetër është se mungon pamja vizuale e objektit nga 4 anët e rrugës, pasi nuk disponohen 4 fotot e objektit bashkëngjitur akt verifikimit në terren datë 01.3.2017, por disponohen vetëm fotot e vet deklarimit pa citimin e datës. Gjithashtu nuk ka përfunduar konstruksioni dhe mbulesa e çatisë, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 62/2015, neni 3.

22.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale ALUIZNI Kamëz-Vorë të verifikojë objektin e legalizuar 1 kat + bodrum, në ZK 2066, pasuria 82/88, pasi është 2 kat mbi tokë, ndryshe nga fotot e objektit, për rrjedhojë provat ti dokumentojë në dosje.

Brenda muajit Qershorit 2018

C. MASA SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi: Dosja me nr, 225 datë 16.03. 2005, e qytetarit A.M.M banues në Vorë ka vetë deklaruar në datë 16.03.2006 se objekti është ndërtuar sipas leje të sheshit të ndërtimit të Bashkisë Vorë nr. 20 dhe leje ndërtimi nr. 21 datë 16.06.1996 me projekt për 4 kat i cili konkretisht i përket pasurisë 40/62 me sipërfaqe totale ndërtimi 432 m². Nga Aluizni Kamëz-Vorë nuk është kërkuar pagesa mbi taksën e infrastrukturës dhe pagesa mbi penalitetet për shklejen e kushteve të lejes për vlerën e tatimit në masën (432 x 32861 x 5 %) në shumën 709,797 lekë. dëm ekonomik.Në dosje nuk gjendet deklarata e qytetarit për përzgjedhjen e objektit që legalizohet. Leja e legalizimit nr. 665 datë 02.6.2015, objekti ka legalizuar më tepër sipërfaqen +174.6 m². Për këtë sipërfaqe qytetari detyrohet ta blejë me vlerën e tregut e cila rezulton **445,440 lekë** (174m² x 2560lekë/m²).

-Qytetari A.M.M sipas deklarimeve 226, 279 është pronar i dy objekteve objekti i përzgjedh prej tij për legalizim është pikërisht pasuria 40/62 e ndodhur në zonën kadastrale 3127 si dhe është banor i katit të parë të ndërtesës së përbashkët me z. G.M me nr. pasurie 40/61, e verifikuar kjo edhe në autocad.

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e ALUIZNI-t Kamëz-Vorë të marrë masat e nevojshme të bllokojë dhe anulojë lejen e legalizimit nr. 665954 datë 02.06.2015 për legalizimin e objektit në ZK 3127 me nr pasurie 40/62 sipërfaqe parcelës ndërtimore 500 m2 dhe sipërfaqe ndërtimi 133, m2 pasi është në të njëjtën ZK 2605 për legalizimin e objektit të dytë të qytetarit A.M.M me nr pasurie 40/61, e verifikuar kjo edhe në autocad. Ky objekt nuk duhet të legalizohet me çmimet e tregut. Gjithashtu, Drejtoria e ALUIZNI-t Kamëz të marrë masa dhe të ndjekë rrugët ligjore të arkëtimit të detyrimit nga qytetari A.M.M për të sipërfaqen që i detyrohet ta blejë me vlerën e tregut në shumën **445,440 lekë** ($174 \times 2560 = 445,440 \text{ lekë}$).

Brenda muajit Prill 2018

2. Gjetje nga auditimi: Dosja me nr. 8655 datë 16.03. 2005, që i përket qytetarit I.L.H banues në Vorë, i cili ka vetë deklaruar në datë 23.12.2014. Nga verifikimi në autocad rezulton se sipërfaqja e objektit dhe e parcelës ndërtimore është 442 m2, dhënë më tepër në lejen e legalizimit 56.5 m2. Nga ALUIZNI Kamëz-Vorë nuk është kërkuar vërtetim mbi pagesa mbi taksën e infrastrukturës dhe pagesa mbi penalitetet për shkeljen e kushteve të lejes për vlerën e tatimit në masën **673,650 lekë** ($410 \times 32861 \times 5 \%$), dëm ekonomik.

2.1. Rekomandimi : Drejtoria e ALUIZNI-t Kamëz-Vorë të marrë masa dhe të ndjekë rrugët ligjore të arkëtimit të detyrimit nga qytetari I.L.H për shkeljen e kushteve të legalizimit të përfituar për vlerën e tatimit në masën **673,650 lekë** ($410 \times 32861 \times 5 \%$), dëm ekonomik.

Deri më 30.06.2018

3.1. Gjetje nga auditimi: Dosja me nr. 1971 datë 17.10.2014, e qytetarit SH.I.D banues në Kamëz, ka vetë deklaruar në datë 15.10.2014, objektin pa leje, pa cilësuar sipërfaqen e ndërtimit nr. kateve dhe parcelën ndërtimore. Qytetari nuk ka paguar detyrimet financiare të kërkuar sipas shkresës nr.1213, datë 31.10.2016 për shumën 760,240 lekë. Këto fatura rezultojnë të anuluar sipas pretendimit se prona është private bazuar në KKP datë 10.11.2015 ,pasuria 146/69 vol 36. Faqe 167 tokë arë sipërfaqe 325 m². Dokumenti i sipërcituar nuk është konfirmuar nga ZRPP Tiranë me shkresën 13784 prot, datë 08.03.2016, çka vërteton se pasuria 146/69, si dhe konfirmimi tjetër me datë 26.10.2016 ka patur parregullsi dhe sipas hartës treguese paraqitet pronë kufizuese.Për rrjedhojë në kërkesën e ALUIZNI-t nr. 1213 datë 31.10.2016 është shmangur arkëtimi i detyrimit në shumën **760, 240 lekë** .

3.1. Rekomandimi : Drejtoria e ALUIZNI-t Kamëz-Vorë të marrë masa dhe të ndjekë rrugët ligjore dhe te saktësojë për të arkëtuar detyrimin nga qytetari SH.I.D të kërkuar sipas shkresës nr. 1213, datë 31.10. 2016 për shumën **760, 240 lekë**.

Deri më 30.06.2018

D. EFEKTE NEGATIVE FINANCIAR

1.Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt: “Evidentimi faktik në terren i ndërtimeve pa leje” të zhvilluar nga AK ish-Drejtoria Rajonale ALUIZNI NR.5 në datën 30.09.2015 u konstatua se:

a. KVO ka s’kualifikuar për disa devijime të vogla, të cilat nuk çenojnë objektin e prokurimit dhe thelbin e kërkesave për kualifikim, ofertën më të ulët të BOE “F.A... shpk & Gj..-V shpk & I.-T shpk & H.. P... shpk” me vlerë 14,997,600 lekë, dhe ka kualifikuar e shpallur fitues ofertën e vendit të dytë BOE “G..Cons.....” shpk & “E.. ”shpk & “Z....” shpk & “D...-E” shpk” me vlerë 15,414,200 lekë, e cila nuk plotëson kriterin e numrit të punonjësve si dhe në marrëveshjen e përbashkët nuk është përcaktuar përqindja e pjesëmarrjes të anëtarëve në shërbimin e ofruar me pasojë efektin financiar në shumën 416,600 lekë (si diferencë mes ofertës së vendit të parë me të dytë). Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin

Publik” i ndryshuar, neni 1/pika b, d, dh, neni 2/ pika a, c ,neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve” dhe neni 53 pika 5 ,neni 55, me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 31.

b. Kontrata nr.501, datë 27.10.2015 me BOE fitues G..Cons.....” shpk & “E.. ”shpk & “Z....” shpk & “D...-E” shpk” , nuk është firmosur për palën sipërmarrëse nga përfaqësuesit e të katër shoqërive që janë anëtarë BOE, si dhe është lidhur për shërbimin e 2252 kateve me vlerë 16,666,667 lekë pa TVSh dhe jo sipas ofertës fituese për 2083 kate me vlerë 15,414,200 lekë pa TVSH me një diferencë prej 1,252,567 lekë, e cila përbën efekt financiar negativ për buxhetin e shtetit. Këto veprime janë në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 4/pika 6 dhe neni 74, me “Kushtet e Përgjithshme të Kontratës” të Shtojca 16 të DST neni 14 “Çmimi i kontratës”.

c. Janë kryer pagesa në favor të BOE fitues G..Cons.....” shpk & “E.. ”shpk & “Z....” shpk & “D...-E” shpk” , sipas kontratës në vlerën 19,997,760 lekë me TVSH, vlerë e cila e tejkalon vlerën 18,016,000 lekë të përlllogaritur me çmim për njësi/kat 8000 lekë për 2252 kate. Pagesa e vlerës së përlllogaritur prej +1,981,760 lekë (19,997,760 lekë- 18,016,000 lekë) përbën efekt financiar negativ. Kjo ka ardhur nga diferenca mbi çmimin zyrtar prej 8000 lekë/kat/ njësi, pasi çmimi prej 8000 lekë/kat/njësi për shërbimin e kryer nga ALUIZNI, që arkëtohet nga qytetarët është përfundimtar dhe mbi të nuk aplikohet TVSH sipas VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 2. Këto veprime janë në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 59, pika 2 dhe neni 14, pika 5.

Rekomandimi: Drejtoria Rajonale ALUIZNI Kamëz-Vorë të marrë masa për të arkëtuar nga BOE G..Cons.....” shpk & “E.. ”shpk & “Z....” shpk & “D...-E” shpk” , nëpërmjet ndalesës së pagesës për diferencë të faturimit në total vlerën prej +1,981,760 lekë, si llogaritje gabim TVSH dhe vlerën prej 3,999,552 lekë si penalitet i llogaritur nga komisioni(pranuar nga ana e grupit auditimit) për kryerje të shërbimit të kontraktuar me vonesë për 50 ditë kalendarike mbi afatin e kontratës. Po kështu në kryerjen e shërbimeve të aplikohen analiza çmimesh me të gjitha detyrimet tatimore.

Brenda muajit Qershor 2018

E. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në Kreu IV, neni 11 germa “d” dhe “e” dhe nenet 37, **141, dhe 153** të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.03.1996, ligjin nr. 9125, datë 29.07.2003 dhe ligjin nr. 136/2015, ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, si dhe në kontratën individuale të punës **ti kërkojmë Drejtorit të ALUIZNI-t Kamëz-Vorë**, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë për çdo punonjës të cituar më poshtë dhe marrjen e masave disiplinore nga **“Vërejtje me shkrim”** deri në **“Largim nga puna”**, për këta punonjës:

I. “Largim nga Puna (zgjidhje e kontratës)”, për 2 punonjës si më poshtë:

1. Z. S.B, ish-Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit, sepse:

-Në 6 raste, në Zonën Kadastrale 3993 dhe 2884, Komuna Paskuqan, ka nënshkruar lejet e legalizimit duke kryer legalizime të objekteve informalë, në Tokë Arë, pronë “SHTET” dhe privat, në afërsi të Rezervuarit të Paskuqanit , **për truall të shitur dhe tjetërsuar në truall privat**, ku nga matjet e kryera në hartën vektoriale, nëpërmjet sistemit AUTOCAD, u konstatua se distanca e objekteve nga bregu i rezervuarit të Paskuqanit është më e vogël se 100 m.

Veprimet e kryera bien në kundërshtim me ligjin nr. 111/2012, datë 15.11.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 1, pika 2, germa “a”; neni 4, pika 8; neni 5 dhe neni 84, si dhe me VKM nr. 280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtimet me leje”, Kreu III, pika 4, germa “dh” dhe Kreu II, pika 2, germa “gj”

-Në 12 raste, në Zonën Kadastrale 3993 dhe 2884, Komuna Paskuqan, ka firmosur lejen e legalizimit dhe ka kryer legalizime të objekteve informale, në Tokë Arë, pronë “SHTET” dhe privat, në afërsi të Lumit të Tiranës, **duke shitur dhe tjetërsuar tokën në truall privat**, ku nga matjet e kryera në hartën vektoriale, nëpërmjet sistemit AUTOCAD, u konstatua se distanca e objekteve nga bregu i të Lumit të Tiranës, është më e vogël se 100 m, distanca brenda së cilave, *pasuria shtetërore është e patjetërsueshme dhe e paparashkrueshme*, në kundërshtim me ligjin nr. 111/2012, datë 15.11.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 1, pika 2, germa “a”; neni 4, pika 8; neni 5 dhe neni 84, si dhe me VKM nr. 280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtimet me leje”, Kreu III, pika 4, germa “dh” dhe Kreu II, pika 2, germa “gj”

-Në 2 raste, në Zonat Kadastrale 3974, 3993,1066 ,2726,etj., ka kryer legalizime të ndërtimeve informale të cilat kufizohen me rrugë automobilistike të kategorive B dhe C, **në distancë prej rrugëve deri në 10 m**, kur distancat e lejuara nga rrugët interurbane të këtyre kategorive janë:

20 m për rrugët e kategorisë B

10 m për rrugët e kategorisë C.

Sa më sipër bie në kundërshtim me VKM nr. 280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, i ndryshuar, Kreu III, pika 4, gjerat “a” dhe “b”, ku distancat nga kufiri rrugor për rrugët e kategorisë “C” brenda qendrave të banuara është 10 m.

- Në të gjitha rastet e audituara ka kryer legalizimin e objekteve informale, në kushtet kur në praktikat mungojnë vërtetimet për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë, në kundërshtim me nenin 27, të ligjit nr. 9482, datë 04.04.2006, mbi pagesën e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë nga pushteti vendor duke krijuar një **mungesë të ardhurash ne buxhetin e shtetit në vlerën 175,886,000 lekë.**

-Në 3 raste, ka kryer legalizimin e objekteve informal në mungesë panëshkrim të deklaratës personale, për marrjen përsipër të përgjegjësisë për cdo pasojë, që mund të rrjedhë nga shkaqe natyrore dhe /ose nga përdorimi i banesës, ku shteti nuk është përgjegjës për kompensimin ose dëmshpërblimin në raste fatkeqësish, për shkak të faktorëve që ndikojnë në qëndrueshmërinë e objektit, *mosveprim në kundërshtim me nenin 27, germa “dh” e ligjit nr. 9482, datë 04.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje, të ndryshuar.*

- Në 1 rast objektet e ndërtuara dhe legalizuar në shkëlqje me nenin 17, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 me ndryshime, leja e legalizimit me nr. 662979 datë 19.01.2015 proceduesi K G P me objekt ndërtimi 142 m² dhe parcele ndërtimore 558.1 m² proceduesit i janë dhënë më tepër **132.1 m² toke shtet e cila** nuk përshtatet me konfiguracionin e parcelës dhe pa deklarate notoriale.

-Në 3 raste, në Zonën Kadastrale 1066, etj., sipas lejeve të legalizimit nr. 70201164, datë 29.01.2016; 665268 datë 09.05.2015; 665265 datë 09.06.2015, ka kryer legalizimin e ndërtimeve informale në kushtet kur këto objekte ndodhen **1-5.3 m** larg nga kanalet kullues kryesorë dhe dytësorë, pra është ngritur brenda brezit mbrojtës të sistemeve kryesore të kullimit, të mbrojtura sipas ligjit nr. 8518, datë 30.7.1999, "Për ujtitjen dhe kullimin", të ndryshuar, si dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, ku distance minimale e lejuar është 4 m – 8m.

– Kane shkelur afatet kohore në kundërshtim me urdherin nr. 37 datë 19.01.2016 për ‘Matricen e procedurave dhe afateve kohore për shqyrtimin administrativ për legalizim e objekteve “ Pika 6 dhe 7 e kësaj matrice dhe mos përputhje me neni 17 (pika 5) dhe nenit 27 të ligjit ligjin 9482, datë. 03.04.2006 me ndryshime si dhe VKM 280 date 01.04.2015 pika 8, duke krijuar vonesa ne likuidimin e tarifave te parcelave ndërtimore , për vlerën **1,556,400,000 lekë + bono privatizimi** si e ardhur e munguar në buxhetin e shtetit per vitin 2016.

Drejtoria e ALUIZNI-t Kamëz - Vorë nuk ka dokumentacion shkresor për shkualifikimin e **1200 objekteve** të ndërtuara **në zonën historike, arkeologjike apo zonë e mbrojtur** dhe nuk disponon dokumentacion për informimin e Drejtorisë së Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë dhe institucionet e vetëqeverisjes vendore në Bashkinë Vorë dhe Bashkinë Kamëz. Veprime në kundërshtim me neni 38 “Dhënia e lejes së legalizimit” dhe nenin dhe 39, të ligjit nr. 9482 datë 03.04.2006 me ndryshime.

-Për periudhën e 6-mujorit të parë 2017 **ka dhënë me vonesë lejet e legalizimit** për 1,635 leje legalizimi për ndërtime dhe shtesa informate (për 548,075 m² sipërfaqe parcele ndërtimore, për 330,529 m² sipërfaqe totale ndërtimore për banim dhe 27,451 m² sipërfaqe ndërtimore për aktivitet social-ekonomike si dhe 187,817 m² sipërfaqe bazë ndërtimi), pasi vet deklaratimet janë bërë në vitin 2006, konstatimi, kualifikimi dhe VKM janë bërë mbi 1 vit më parë, çka ka nxjerrë jo me efektivitet punën e ALUIZNIT, në përmbushjen e misionit të legalizimit të zonave informate, në kundërshtim me nenin 28 të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar.

-Nuk është respektuar në disa raste afati prej 60 ditësh nga data e mbajtjes së procesverbalit të konstatimit në terren deri në marrjen e vendimit për kualifikimin ose jo të objektit, në kundërshtim me VKM nr. 280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, pika 8.

2. Znj. E.B, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit, sepse:

Në 4 raste, në Zonën Kadastrale 3993 dhe 2884, Komuna Paskuqan, sipas lejeve të legalizimit nr. 70207121, datë 28.03.2017; 70207773, dt. 23.05. 2017; 70207949, dt. 31.05. 2017; nr. 70207945, datë 31.05.2017, ka kryer legalizime të objekteve informal, në Tokë Arë, pronë “SHTET” dhe privat, në afërsi të Rezervuarit të Paskuqanit **,për një sipërfaqe të shitur dhe tjetërsuar në truall privat**, ku nga matjet e kryera në hartën vektoriale, nëpërmjet sistemit AUTOCAD, u konstatua se distanca e objekteve nga bregu i rezervuarit të Paskuqanit është më e vogël se 100 m,

Në këto distanca nga rezervuari, *pasuria shtetërore është e patjetërsueshme dhe e papërshkrueshme.*

Veprimet e kryera bien në kundërshtim me ligjin nr. 111/2012, datë 15.11.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 1, pika 2, germa “a”; neni 4, pika 8; neni 5 dhe neni 84, si dhe me VKM nr. 280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, Kreu III, pika 4, germa “dh” dhe Kreu II, pika 2, germa “gj”.

-Në 2 raste, në Zonat Kadastrale 3974, 3993,1066 dhe 2726, sipas lejeve të legalizimit nr. 70207166, datë 29.03.2017; 70207279, datë 31.03.2017; ka kryer legalizime të ndërtimeve informale të cilat kufizohen me rrugë automobilistike të kategorive B dhe C, **në distancë prej rrugëve deri në 10 m**, kur distancat e lejuara nga rrugët interurbane të këtyre kategorive janë:

20 m për rrugët e kategorisë B

10 m për rrugët e kategorisë C.

Sa më sipër bie në kundërshtim me VKM nr. 280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, i ndryshuar, Kreu III, pika 4, gjerat “a” dhe “b”, ku distancat nga kufiri rrugor për rrugët e kategorisë “C” brenda qendrave të banuara është 10 m.

- Në të gjitha rastet e audituara ka kryer legalizimin e objekteve informalë, në kushtet kur në praktikat mungojnë vërtetimet për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë, në kundërshtim me nenin 27, të ligjit nr. 9482, datë 04.04.2006.

-Në 5 raste, sipas lejeve të legalizimit nr. 70205492, datë 02.11.2016; nr. 70207121, datë 28.03.2017; 70208092, datë 19.06.2017; 70208722, datë 25.09.2017; 70207945, datë 31.05.2017, ka kryer legalizimin e objekteve informal në mungesë panëshkrim të deklaratës personale, për marrjen përsipër të përgjegjësisë për cdo pasojë, që mund të rrjedhë nga shkaqe natyrore dhe /ose nga përdorimi i banesës, ku shteti nuk është përgjegjës për kompensimin ose dëmshpërblimin në raste fatkeqësish, për shkak të faktorëve që ndikojnë në qëndrueshmërinë e objektit, *mosveprim në kundërshtim me nenin 27, germa “dh” e ligjit nr. 9482, datë 04.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje, të ndryshuar.*

- Mungesë të “Dokumentacioni tekniko-ligjor për legalizimin e objektit”, pika “ç” **vërtetimin për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë** me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 me ndryshime, mbi pagesën e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë nga pushteti vendor duke krijuar një mungesë të ardhurash ne buxhetin e shtetit në vlerën **175,886,000 lekë** .

- **Në të gjitha rastet e audituara** ka kryer legalizimin e objekteve informale, në kushtet kur në praktikat mungojnë vërtetimet për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë, në kundërshtim me nenin 27, të ligjit nr. 9482, datë 04.04.2006, mbi pagesën e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë nga pushteti vendor duke krijuar një **mungesë të ardhurash ne buxhetin e shtetit në vlerën 175,886,000 lekë.**

-**Në 3 raste, në Zonën Kadastrale 1066, etj.,** sipas lejeve të legalizimit nr. 70201164, datë 29.01.2016; 665268 datë 09.05.2015; 665265 datë 09.06.2015, ka kryer legalizimin e ndërtimeve informale në kushtet kur këto objekte ndodhen **1-5.3 m** larg nga kanalet kullues kryesorë dhe dytësorë, pra është ngritur brenda brezit mbrojtës të sistemeve kryesore të kullimit, të mbrojtura sipas ligjit nr. 8518, datë 30.7.1999, "Për ujitjen dhe kullimin", të ndryshuar, si dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, ku distance minimale e lejuar është 4 m – 8m.

– Kanë shkelur afatet kohore në kundërshtim me urdhrin nr. 37 datë 19.01.2016 për 'Matricën e procedurave dhe afateve kohore për shqyrtimin administrativ për legalizim e objekteve " Pika 6 dhe 7 e kësaj matrice dhe mos përputhje me neni 17 (pika 5) dhe nenit 27, të ligjin 9482, datë. 03.04.2006 me ndryshime si dhe VKM 280 datë 01.04.2015 pika 8, duke krijuar vonesa ne likuidimin e tarifave te parcelave ndërtimore, për vlerën **1,556,400,000 lekë + bono privatizimi** si e ardhur e munguar në buxhetin e shtetit per vitin 2016.

Drejtoria e ALUIZNI-t Kamëz - Vorë nuk ka dokumentacion shkresor për shkualifikimin e **1200 objekteve** të ndërtuara në zonën historike, arkeologjike apo zonë e mbrojtur dhe nuk disponon dokumentacion për informimin e Drejtorisë së Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë dhe institucionet e vetëqeverisjes vendore në Bashkinë Vorë-Kamëz. Veprime në kundërshtim me neni 38 "Dhënia e lejes së legalizimit" dhe nenin dhe 39, të ligjit nr. 9482 datë 03.04.2006 me ndryshime .

-Për periudhën e 6-mujorit të parë 2017 **ka dhënë me vonesë lejet e legalizimit** për 1,635 leje legalizimi për ndërtime dhe shtesa informate (për 548,075 m2 sipërfaqe parcele ndërtimore, për 330,529 m2 sipërfaqe totale ndërtimore për banim dhe 27,451 m2 sipërfaqe ndërtimore për aktivitet social-ekonomike si dhe 187,817 m2 sipërfaqe bazë ndërtimi), pasi vet deklaratimet janë bërë në vitin 2006, konstatimi, kualifikimi dhe VKM janë bërë mbi 1 vit më parë, çka ka nxjerrë jo me efektivitet punën e ALUIZNIT, në përmbushjen e misionit të legalizimit të zonave informate, në kundërshtim me nenin 28 të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje" i ndryshuar.

-**Nuk është respektuar në disa raste afati prej 60 ditësh** nga data e mbajtjes së procesverbalit të konstatimit në terren deri në marrjen e vendimit për kualifikimin ose jo të objektit, në kundërshtim me VKM nr. 280, datë 1.4.2015 "Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje", pika 8.

II. Masa "Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna" deri në "Largim nga Puna (zgjidhje e kontratës)", për punonjësit, si më poshtë:

1. Znj. E.V, me detyrë specialist i Sektorit të Legalizimit.
2. Z. D.T, me detyrë specialist i legalizimit.
3. Z. LL.M, me detyrë specialist legalizimi.
4. Z. F.P, me detyrë specialist i Sektorit të Hartografisë.
5. Znj. N.K, me detyrë specialiste e legalizimit.
6. Znj. R.M, me detyrë specialist legalizimi.
7. Znj. E.M, me detyrë specialist legalizimi
8. Znj. M.Ç, me detyrë specialiste e legalizimit
9. Znj. S.S, me detyrë specialiste legalizimi.
10. Z. P.M me detyrë specialiste e legalizimit.
11. Z. E.K, me detyrë specialiste e legalizimit.
12. Z. D.K, me detyrë specialiste e legalizimit.
13. Z. G.GJ me detyrë specialiste e legalizimit.

14. Z. B.K, me detyrë specialiste e legalizimit.

15. Z. P.GJ, me detyrë specialiste e legalizimit.

16. Z. XH.Q me detyrë specialiste e legalizimit.

-Në 12 raste, në Zonën Kadastrale 3993 dhe 2884, Komuna Paskuqan, sipas lejeve të legalizimit nr. 70207121, datë 28.03.2017; 70207773, dt. 23.05. 2017; 70208544, dt. 13.09. 2017; 70208419, dt. 23.08. 2017; 70208579, dt. 18.09. 2017; 70208302, dt. 31.07. 2017; 70207949, dt. 31.05. 2017; 70208236, dt. 25.07. 2017; 70208329, dt. 08.01. 2017; 70208452, dt. 31.08. 2017; nr. 70207945, datë 31.05.2017, nr. 70208339, datë 08.02.2017, ka nënshkruar lejet e legalizimit duke kryer legalizime të objekteve informale, në Tokë Arë, pronë “SHTET” dhe privat, në afërsi të Rezervuarit të Paskuqanit , **për truall të shitur dhe tjetërsuar në truall privat**, ku nga matjet e kryera në hartën vektoriale, nëpërmjet sistemit AUTOCAD, u konstatua se distanca e objekteve nga bregu i rezervuarit të Paskuqanit është më e vogël se 200 m, distancë që luhatet në segmentin 10 m -196 m;

Veprimet e kryera bien në kundërshtim me ligjin nr. 111/2012, datë 15.11.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 1, pika 2, germa “a”; neni 4, pika 8; neni 5 dhe neni 84, si dhe me VKM nr. 280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtimet me leje”, Kreu III, pika 4, germa “dh” dhe Kreu II, pika 2, germa “gj”

-Në 1 rast, në Zonën Kadastrale 3993 dhe 2884, Komuna Paskuqan, sipas lejes së legalizimit 70208582, Dt.19.09.2017; ka firmosur lejen e legalizimit dhe ka kryer legalizime të objekteve informale, në Tokë Arë, pronë “SHTET” dhe privat, në afërsi të Lumit të Tiranës, **duke shitur dhe tjetërsuar tokën në truall privat**, ku nga matjet e kryera në hartën vektoriale, nëpërmjet sistemit AUTOCAD, u konstatua se distanca e objekteve nga bregu i të Lumit të Tiranës, është më e vogël se 100 m, distancë (97 m), distancë brenda së cilës, *pasuria shtetërore është e patjetërsueshme dhe e paparashkrueshme*, në kundërshtim me ligjin nr. 111/2012, datë 15.11.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 1, pika 2, germa “a”; neni 4, pika 8; neni 5 dhe neni 84, si dhe me VKM nr. 280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtimet me leje”, Kreu III, pika 4, germa “dh” dhe Kreu II, pika 2, germa “gj”

- Në 4 raste, në Zonat Kadastrale 3974, 3993,1066 ,2726,etj., sipas lejeve të legalizimit nr. nr. 70207166, datë 29.03.2017; 70207279, datë 31.03.2017; nr. 70208458, datë 31.08.2017; nr. 70208665, datë 05.09.2017, ka kryer legalizime të ndërtimeve informale të cilat kufizohen me rrugë automobilistike të kategorive B dhe C, **në distancë prej rrugëve deri në 10 m**, kur distancat e lejuara nga rrugët interurbane të këtyre kategorive janë:

20 m për rrugët e kategorisë B

10 m për rrugët e kategorisë C.

Sa më sipër bie në kundërshtim me VKM nr. 280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, i ndryshuar, Kreu III, pika 4, gjerat “a” dhe “b”, ku distancat nga kufiri rrugor për rrugët e kategorisë” C” brenda qendrave të banuara është 10 m.

- Në të gjitha rastet e audituara ka kryer legalizimin e objekteve informal, në kushtet kur në praktikat mungojnë vërtetimet për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë, në kundërshtim me nenin 27, të ligjit nr. 9482, datë 04.04.2006.

-Në 12 raste, sipas lejeve të legalizimit nr. 70205492, datë 02.11.2016 nr. 70207121, datë 28.03.2017; 70208092, datë 19.06.2017; 70208544, datë 13.09.2017; 70208419, datë 23.08.2017; 70208579, datë 18.09.2017; 70208582, datë 19.09.2017; 70208722, datë 25.09.2017; 70207945, datë 31.05.2017, 70208329, datë 08.01.2017; 70208236, datë 25.07.2017; nr.70208339, datë 08.02.2017; ka kryer legalizimin e objekteve informal në mungesë pa nënshkrim të deklaratës personale, për marrjen përsipër të përgjegjësisë për çdo pasojë, që mund të rrjedhë nga shkaqe natyrore dhe /ose nga përdorimi i banesës, ku shteti nuk është përgjegjës për kompensimin ose dëmshpërblimin në raste fatkeqësish, për shkak të faktorëve që ndikojnë në qëndrueshmërinë e objektit, *mosveprim në kundërshtim me nenin 27, germa “dh” e ligjit nr. 9482, datë 04.04.2006* “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje, të ndryshuar.

- **Në të gjitha rastet e audituara** ka kryer legalizimin e objekteve informal, në kushtet kur në praktikat mungojnë vërtetimet për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë, në kundërshtim me nenin 27, të ligjit nr. 9482, datë 04.04.2006, mbi pagesën e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë nga pushteti vendor duke krijuar një **mungesë të ardhurash ne buxhetin e shtetit në vlerën 175,886,000 lekë.**

- Kane shkelur afatet kohore në kundërshtim me urdhrin nr. 37 datë 19.01.2016 për 'Matricën e procedurave dhe afateve kohore për shqyrtimin administrativ për legalizim e objekteve " Pika 6 dhe 7 e kësaj matrice dhe mos përputhje me neni 17 (pika 5) dhe nenit 27 të ligjit 9482, datë. 03.04.2006 me ndryshime si dhe VKM 280 date 01.04.2015 pika 8, duke krijuar vonesa ne likuidimin e tarifave te parcelave ndërtimore , për vlerën **1,556,400,000 lekë + bono privatizimi** si e ardhur e munguar në buxhetin e shtetit për vitin 2016.

-Për periudhën e 6-mujorit të parë 2017 **ka dhënë me vonesë lejet e legalizimit** për 1,635 leje legalizimi për ndërtime dhe shtesa informate (për 548,075 m² sipërfaqe parcele ndërtimore, për 330,529 m² sipërfaqe totale ndërtimore për banim dhe 27,451 m² sipërfaqe ndërtimore për aktivitet social-ekonomike si dhe 187,817 m² sipërfaqe bazë ndërtimi), pasi vet deklaratimet janë bërë në vitin 2006, konstatimi, kualifikimi dhe VKM janë bërë mbi 1 vit më parë, çka ka nxjerrë jo me efektivitet punën e ALUIZNIT, në përmbushjen e misionit të legalizimit të zonave informate, në kundërshtim me nenin 28 të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje" i ndryshuar.

-**Nuk është respektuar në disa raste afati prej 60 ditësh** nga data e mbajtjes së procesverbalit të konstatimit në terren deri në marrjen e vendimit për kualifikimin ose jo të objektit, në kundërshtim me VKM nr. 280, datë 1.4.2015 "Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje", pika 8 .

-**Në në 3 raste, në Zonën Kadastrale 1066, etj.,** sipas lejeve të legalizimit nr. 70201164, datë 29.01.2016; 665268 datë 09.05.2015; 665265 datë 09.06.2015, ka kryer legalizimin e ndërtimeve informale në kushtet kur këto objekte ndodhen **1-5.3 m** larg nga kanalet kullues kryesorë dhe dytësorë, pra është ngritur brenda brezit mbrojtës të sistemeve kryesore të kullimit, të mbrojtura sipas ligjit nr. 8518, datë 30.7.1999, "Për ujitjen dhe kullimin", të ndryshuar, si dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, ku distance minimale e lejuar është 4 m – 8m.

- **Drejtoria e Aluiznit Kamëz-Vorë** nuk ka mbajtur evidenca mbi përfaqet e lira në pronësi shtet lënë jashtë procesit të legalizimit dhe të pamundura për parcelizim për vetë pozicionin gjeografik që kanë, **por që posedohen nga subjektet pa asnjë detyrim financiar apo qiraje, pra nuk ka marrë asnjë masë për të njoftuar dhe bashkëpunuar me institucionet vendore, për vënien në dispozicion të listës së sipërfaqeve të lira, konfirmimin e tyre në pronësi shtet, apo vlerësimin e tyre si troje që përdoren nga qytetarët, pa u taksuar ose për kthim në ambiente publike.** -**Mungon deklaratat noteriale nga individët të cilat pranojnë ose refuzojnë të blejnë truallin sipas çmimit të tregut për pjesën e parcelës të zaptuar e cila është mbi normën ligjore, mbi 3- fish dhe nën 500 m².**

-**Këto parcela janë zvogëluar me qëllim për të qenë në kufirin deri në 300/500 m²,** sipas genplaneve, hartës fushore, ortofotos digjitale dhe hartës vektoriale të pronësive, ku sipërfaqet e pa legalizuara duhet t'i ishin bashkëngjitur sipërfaqes së legalizuar për vetë pozicionin gjeografik që ndodhen, në kundërshtim me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 30, datë 15.01.16 "Për mënyrën e hartimit dhe paraqitjes së dokumentacionit teknik (gen-plan, planimetri)", i ndryshuar, si dhe shkronja "f" dhe "g" e nenit 3 dhe pika 1 e nenit 17, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", i ndryshuar.

- Në **3 raste** u konstatua ndryshim të numrit të ZK dhe në 1 rast ndryshim të numrit të pasurisë, konkretisht:

-pasuria 40/55/2 në zonën kadastrale 2183 paraqitet ndryshe në dokumentet e hipotekës, pasi ajo përcaktohet në ZK 3127. Theksojmë se kjo pasuri kufizohet me pasurinë 40/53, e cila shtrihet në ZK 2726. Po kështu është ndryshuar pasuria nga 54/97 në pasurinë 54/197.

- Pasuria 38/10/1 paraqitet në ZK 2066 (sipas genplanit), ndërsa në Lejen e legalizimit nr. 666456, datë 7.8.2015, në akt kualifikimin datë 14.07.2015 dhe në certifikatën e pronësisë datë 12.10.2005 kjo pasuri 38/10 (me sipërfaqe totale 401,4 m²) pasqyrohet në ZK 1649.

-Në 4 raste nuk përcaktohet hyrja në parcelën ndërtimore ose në objekt, sipas genplanit, në kundërshtim me pikën 1.3, Urdhër nr. 291, datë 01.09.2008, “Për miratimin e manualit “Hartimi dhe paraqitja e materialeve grafike (genplan, ortofoto, planimetri), të objektit që legalizohet“, me pikën 2.7/c/iii të urdhrit nr. 8 datë 30.10.2006 “Për miratimin manualit të hartimit dhe paraqitjes së materialeve grafike”, konkretisht:

- pasuria shtet 9/893, në ZK 3992, banesë 2 kat me leje legalizimi nr. 70207607, datë 30.04.2017,
- pasuria 2/296, në ZK 3992, banesë 1 kat me leje legalizimi nr. 70207266, datë 31.3.2017,
- pasuria 40/55/2, në ZK 2183, godinë e kombinuar 3 kat Vorë me leje legalizimi nr. 70207076,
- pasuria 38/10, ZK 1649, objektit informal 3 kat banimi Valias, Kamëz.

- Në 7 raste mungon statusi juridik i pasurisë, në kundërshtim me nenin 27/d të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” ndryshuar me ligjin 50/2014, dhe nr. 62/2015, përkatësisht:

- * godinë banimi 1 kat, Paskuqan, Kamëz, , për parcelën ndërtimore 103,2 m² në ZK 1066, pasuria 230/375. me leje legalizimi nr. 70206564, datë 27.01.2017,
- * godinë banimi 2 kat +1 kat nën tokë Vorë, për parcelën ndërtimore 373,5 m² , në ZK 2183, pasuria 182/30/10, me leje legalizimi nr. 70206819, datë 17.02.2017,
- * godinë banimi 1 kat Kamëz, për parcelën ndërtimore 274,5 m² , në ZK 2066, pasuria 82/88, me leje legalizimi nr. 70206750, datë 13.02.2017,
- * godinë banimi 1 kat Kamëz, për parcelën ndërtimore me sipërfaqe 260 m² në ZK 2066, pasuria 12/26, me leje legalizimi nr. 70206814, datë 16.02.2017,
- * godinë banimi 1 kat+papafino, Vorë, për parcelën ndërtimore 343,5 m², në ZK 2596, pasuria 135/97/1, me leje legalizimi nr. 70208051, datë 15.06.2017,
- * godinë shërbimi 1 kat, Paskuqan, për parcelën ndërtimore 350,7 m² në ZK 3993, pasuria 1225/4, me leje legalizimi nr. 70207390, datë 11.04.2017,
- * godinë shërbimi 2 kat Kamëz, për parcelën ndërtimore me sipërfaqe 75,3 m² në ZK 2066, pasuria 52/144/2, me leje legalizimi 70206935, datë 27.02.2017 (Trajtuar në faqet 156-170 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

-Në 2 raste nuk është legalizuar ngrehina funksionale (mur rrethues ose ngrehinë ndihmëse) brenda sipërfaqes parcelës ndërtimore, konkretisht:

* godinë e kombinuar 5 kat Kamëz, me leje legalizimi 70207397, datë 10.04.2017, për parcelën ndërtimore me sipërfaqe 500 m², në ZK 2066, pasuria 347/14/2, nuk është legalizuar ngrehina funksionale 1 kat me 40 m² dhe 60 ml mur rrethues brenda sipërfaqes parcelës ndërtimore, sipas procesverbalit të terrenit datë 01.03.2007 dhe vet deklarimit të subjektit date 15.08.2006. Ndryshe është vepruar tek legalizimi i godinës të banimit të 3 kat ZK 2066, pasuria 123/11 ku është legalizuar edhe objekti ndihmës.

*, banesë 1 kat, me leje legalizimi nr. 70207266, datë 31.3.2017, për parcelën ndërtimore me sipërfaqe 180 m² në ZK 3992, pasuria 2/296, nuk është legalizuar ngrehina funksionale ose muri rrethues 40 ml pasqyruar në vet deklarimin datë 17.11.2006 brenda sipërfaqes parcelës ndërtimore,

Veprime në kundërshtim me pikën 2 të nenit 2 ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje“, ndryshuar me ligjin nr. 50/2014 neni 2, pika 3.

-Në 4 raste u konstatua mosrespektim të distancës të ndërtimit informal nga rruga kombëtare në 1 rast objekti i legalizuar ndodhet në kushtet mos respektimit të distancës mbi 100 metra nga bregu i rezervuarit (liqenit) Paskuqan, ku sipas dokumentacionit në dosje, si genplani, harta dixhitale e paraqitur, rezulton se objektet ndodhen në një distancë prej cepit të rrugës nacionale me pak se përcaktimet ligjore, në kundërshtim me nenin 39 të Ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” të ndryshuar, me kap II/a të VKM nr. 280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, me Ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998 i ndryshuar “Kodi rrugor në Republikën e Shqipërisë”, neni 2 “Përcaktime dhe klasifikime rrugësh” dhe neni 4, “Përcaktimi i qendrave të banuara”, me VKM nr. 153, date 07.04.2000 “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor në Republikën e Shqipërisë” neni 25, pika 2 si dhe me VKM nr. 756

datë...10.2016 pika 2 /a/i, kapitulli II ku thuhet: **20 metra për rrugët e kategorisë B....**, konkretisht:

* godinë banimi 2 kat Vorë, për parcelën ndërtimore me sipërfaqe 234 m² në ZK 2605, pasuria 40/59, rezulton se sipas ortofotos digjitale, planimetrisë (*skicës fushore genplanit*) të akt konstatimit në terren datë 26.08.2014 pasqyrohet 7,4 metër nga rruga Tr-D, nga mbi 20 metër që duhej. Objekti është kualifikuar dhe është në pritje (proces) për pajisjen me leje legalizimi.

* ndërtimi informal 5 kat bashkëngjitur me shtesën 2 kat i legalizuar me lejen 70207397, datë 10.04.2017, në ZK 2066, pasuria 347/14/2, ku paraqet ngushtim të trotuarit pranë rrugës nacionale Bulevardi Blu (B), pasi shkallët hyrëse të katit II dhe tenda e marketit të katit përdhe të objektit shtrihen dhe prekin pjesërisht trotuarin e këmbësorëve.

*, godinë banimi 2 kat +1 kat nën tokë Vorë, me leje legalizimi 70206999 datë 17.03.2017, për parcelën ndërtimore me sipërfaqe 416,5 m², në ZK 3127, pasuria 40/87, objekti ndodhet në distancën 13,3 metra larg rrugës nacionale, sipas planimetrisë (*skicës fushore genplanit*) të akt konstatimit në terren datë 10.01.2014.

* godinë shërbimi 1 kat, Kamëz, për parcelën ndërtimore shtet me sipërfaqe 94,3 m² (*sipërfaqe ndërtimi 34,4 m² dhe sipërfaqe totale ndërtimi 34,4 m²*, në ZK 3992, pasuria 11/81, nuk është respektuar distanca e ndërtimit informal (dyqan fruta perime) me rrugën nacionale bulevardi blu, pasi është 0,5 metër, sipas hartës vektoriale dhe jo 2.4 metër sipas akt verifikimit në terren datë 30.01.2017. Theksojmë se relacioni i hartografisë, sektorit pronësisë dhe sektorit Legalizimit nuk e justifikon legalizimin e objektit, pasi është zvogëluar me 6,19 m² parcela ndërtimore dhe jo objekti, pasi problem paraqet objekti i cili është afër me rrugën nacionale. Mungon pamja vizuale e objektit nga 3 anët e rrugës, si dhe mungojnë 3 fotot e objektit në terren, por është mjaftuar vetëm me fotografimin e objektit nga prapa.

* godinë e kombinuar 4 kat, Vorë, me leje legalizimi nr. 70206809, datë 15.02.2017, në ZK 2726, pasuria 40/53, rezulton se: nuk është respektuar distanca 20 metër e ndërtimit informal (*godinë 4 kat e kombinuar*) me rrugën nacionale Autostrada, pasi është 6,5 metër dhe 14 metër në cepin tjetër të objektit, sipas planimetrisë (*skicës fushore*) në terren date 26.10.2016, ndërsa nga matjet tek harta vektor sipas fotografimit satelitor distanca rezulton 1,8 metër nga rruga.

* *godinë banimi 2 kat Paskuqan, me leje legalizimi 70208501, datë 07.09.2017, për parcelën ndërtimore me sipërfaqe 500 m² në ZK 2884, pasuria 697/4, veprim në kundërshtim me nenin 1 pika 2/a, neni 4 pika 8, neni 5 dhe neni 84 të ligjit nr. 111/2012 datë 15.12.2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", me VKM nr. 280, datë 01.04.2015 kap II/gj.*

-Në 1 rast objekti informal,ndodhet 1,9 metër afër objektit të kultit Xhamia, sipas gen planit dhe planimetrisë të inspektorëve të terrenit datë 02.12.2016, (*godinë banimi 2 kat, Valias i ri, Kamëz, për parcelën ndërtimore 420,9 m² në ZK 2066, pasuria 43/108/1*).

- Në 1 rast objekti informal 1- kat paraqitet karabina pa mbulesë me çati ose soletë (*godinë banimi 1 kat Kamëz me leje legalizimi nr. 70206750, datë 13.02.2017, për parcelën ndërtimore me sipërfaqe 274,5 m², në ZK 2066, pasuria 82/88*), sipas fotove të vet deklaruesit, në kundërshtim me ligjin nr. 50/2014 ndryshuar me nr.62/2015 neni 3, shkronja "a".

-Në 1 rast objekti i legalizuar 1 kat + podrum, rezulton ndryshe sipas fotove të objektit, pasi është 2 kat mbi tokë, konkretisht godinë shërbimi e kombinuar 1 kat+podrum mbi tokë, në ZK 2066, pasuria 27/31/1. Fakt tjetër është se mungon pamja vizuale e objektit nga 4 anët e rrugës, pasi nuk disponohen 4 fotot e objektit bashkëngjitur akt verifikimit në terren datë 01.3.2017, por disponohen vetëm fotot e vet deklarimit pa citimin e datës. Gjithashtu nuk ka përfunduar konstruksioni dhe mbulesa e çatisë, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 62/2015, neni 3.

- Në 1 rast objekti informal godinë e kombinuar 5 kat Kamëz, në ZK 2066, pasuria 347/14/2, paraqet bashkëngjitur shtesën 2 kat të legalizuar, e cila ka ngushtuar trotuarin pranë rrugës nacionale Bulevardi Blu (B), pasi shkallët hyrëse të katit II dhe tenda e marketit të katit përdhe të objektit shtrihen dhe prekin pjesërisht trotuarin e këmbësorëve, në kundërshtim me nenin 31/1/a dhe 39 të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje" të ndryshuar, me pikën 4/a/b të VKM nr. 438, datë 28.6.2006 si dhe me ligjin nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", me VKM nr. 502, datë 13.07.2011 "Për miratimin e rregullores të kontrollit të zhvillimit të territorit" e ndryshuar me

VKM nr. 88, datë 07.02.2012, VKM nr. 139, datë 22.02.2012, VKM nr. 345, datë 09.05.2012 dhe VKM nr. 314, datë 13.3.2013.

- **Në 1 rast objekti i legalizuar është ngjitur me kolektorin** (godinë banimi 1 kat Kamëz, në ZK 2066, pasuria 82/88), sipas planimetrisë (genplanit) të inspektorëve terrenit, në kundërshtim me ligjin nr. 50/2014 neni 39. Dokumentacioni paraqet kontradikta, pasi në vet deklarim thuhet se kufizohet nga 2 kufitarë privat dhe 2 anët tjera me kanal dhe kolektor, ndërsa në planimetrinë përmenden 3 kufitarë privat dhe në jug thuhet rrugë.

- Në Dosjen me nr, 225 datë 16.03. 2005, e qytetarit A.M.M banues në Vorë ka vetë deklaruar në datë 16.03.2006 se objekti është ndërtuar sipas leje të sheshit të ndërtimit të Bashkisë Vorë nr. 20 dhe leje ndërtimi nr. 21 datë 16.06.1996 me projekt për 4 kat i cili konkretisht i përket pasurisë 40/62,(*trajtuar më poshtë*) në sipërfaqe totale ndërtimi 432 m². Nuk është kërkuar pagesa mbi taksën e infrastrukturës dhe pagesa mbi penalitetet për shkeljen e kushteve të lejes për vlerën e tatimit në masën (432 x 32861 x 5 %) në shumën 709,797 lekë. dëm ekonomik..Në dosje nuk gjendet deklarata e qytetarit për përzgjedhjen e objektit që legalizohet. Leja e legalizimit nr. 665 datë 02.6.2015, objekti ka legalizuar më tepër sipërfaqen 174.6 m². Për këtë sipërfaqe qytetari detyrohet ta blejë me vlerën e tregut e cila rezulton 445,440 lekë (174 x 2560 = **445,440 lekë**).

-Qytetari A.M.M sipas deklarimeve 226, 279 është pronar i dy objekteve objekti i përzgjedh prej tij për legalizim është pikërisht pasuria 40/62 e ndodhur në zonën kadastrale 3127 si dhe është banor I katit të parë të ndërtesës së përbashkët me z. G.M me nr. pasurie 40/61, e verifikuar kjo edhe në autocad.

-**Në Dosjen me nr. 8655 datë 16.03. 2005**, e qytetarit I.L.H banues në Vorë, i cili ka vetë deklaruar në datë 23.12.2014. Nga verifikimi në autocad rezulton se sipërfaqja e objektit dhe e parcelës ndërtimore është 442 m² dhëna më tepër në lejen e lgalizimit 56.5 m². Nga aluizni nuk është kërkuar vërtetim mbi pagesa mbi taksën e infrastrukturës dhe pagesa mbi penalitetet për shkeljen e kushteve të lejes për vlerën e tatimit në masën (410 x 32861 x 5 %) në shumën 673, 650. lekë. dëm ekonomik.

Në Dosjen me nr. 1971 datë 17.10.2014, e qytetarit SH.I.D banues në Kamëz, ka vetë deklaruar në datë 15.10.2014, objektin pa leje, pa cilësuar sipërfaqen e ndërtimit nr. kateve dhe parcelën ndërtimore. Qytetari nuk ka paguar detyrimet financiare të kërkuar sipas shkresës nr. 1213, datë 31.10. 2016 për shumën 760, 240 lekë. Këto fatura rezultojnë të anuluar sipas pretendimit se prona është private bazuar në KKP datë 10.11.2015 ,pasuria 146/69 vol 36. Faqe 167 tokë arë sipërfaqe 325 m². Dokumenti i sipërcituar nuk është konfirmuar nga ZRPP Tiranë me shkresën 13784 prot, datë 08.03.2016, c'ka vërteton se pasuria 146/69 si dhe konfirmimi tjetër me datë 26.10.2016. ka patur parregullsi dhe sipas hartës treguese paraqitet pronë kufizuese. Për rrjedhojë kërkesa e Aluiznit nr. 1213 datë 31.10.2016 për arkëtimin e detyrimeve në shumën 760, 240 lekë është shmangur.

C- Për punonjësit e larguar dhe që nuk kanë adresim institucional.

V. Për 42 ish punonjësit të mare me kontrata të përkohshme, për shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit të tyre. Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore, do të ishte nga "***Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna***" deri në masën "***Largim nga Puna (zgjidhje e kontratës)***".

E. KALLËZIM PENAL:

Bazuar në nenin 281, të ligjit nr. 7905 datë 21.03.1995 "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, pika "gj" e nenit 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin, integrimin e zonave informale", i ndryshuar dhe VKM nr. 280, datë 01.04.2015 "Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të

kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje", *sugjerojmë trajtimin e detajuar tekniko juridik rast pas rasti* nga ana e Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, të materialeve të evidentuara nga grupi i auditimit, në kuptim të referencave të Kodit Penal **për 7 punonjës**, si më poshtë:

- 1. Z. S. B, ish-Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit,**
- 2. Znj. E. B, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit,**
- 3. Z. F.P, me detyrë specialist i Sektorit të Hartografisë**
- 4. Z. A. J, me detyrë ish-Përgjegjës i Sektorit të Hartografisë**
- 5. Z. F.G, me detyrë ish-Përgjegjës i Sektorit të Hartografisë.**
- 6. Z. F.G, me detyrë ish-Përgjegjës i Sektorit të Hartografisë.**
- 7. Znj. N.K, me detyrë specialiste e legalizimit,** pasi me veprimet dhe mosveprimet e tyre në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore, kanë shpërdoruar detyrën zyrtare..

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Drejtoria Juridike, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës dhe Departamenti i Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R